DEKRET
Nr. 443, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa "ç", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1
Dhënien e dekoratës "Oficer i Madh i Urdhrit të Skënderbeut"
zotit Matteo Mandalà

"Në vlerësim të kontributeve të panumërta e shumë të çmuara në përparimin e studimeve ndërdisiplinore në fushën e albanologjisë, me një veprimtari të pareshtur hulumtuese dhe publicistike të nivelit më të lartë akademik, si edhe për aktivizimin e një jete në mbajtjen gjallë të katedrave të gjuhës shqipe në Itali, në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë, të së tashmes dhe të së ardhmes të komuniteteve arbëreshe dhe të thesarit mbarëkombëtar të Motit të Madh".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj